Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 104/02-1700/22
Kaçanik, 28.01.2022

Në bazë nenit 12.2 (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 4.3 të Statutit të Asociacionit të Komunave të Kosovës Nr. 237/15 të datës 16.06.2015, të Kërkesës së Asociacionit të Komunave të Kosovës prej datës 14 janar 2022, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 28 janar 2022, mori këtë:

**VENDIM**
**PËR DELEGIMIN E DY ANËTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS KAÇANIK, NË KUVENDIN E ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE TË KOSOVËS**

**1.** Me këtë Vendim, delegohen 2 anëtarë nga Kuvendi i Komunës Kaçanik, përfaqësues në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës:

1.1. Selajdin Troni, anëtar i KK nga subjekti politik i PDK; dhe
1.2. Bashkim Luma, anëtar i KK nga subjekti politik i LVV.

**2.** Delegimi i 2 anëtarëve nga pika 1. e këtij vendimi bëhet sipas Kërkesës së AKK, në bazë kritereve të përcaktuara në Statutin e AKK.

**3.** Detyrat e anëtarëve të deleguar në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës janë të përcaktuara në Statutit e AKK.

**4.** Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është, Kërkesa e Asociacionit të Komunave të Kosovës e datës 14 janar 2022.

**5.** Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

**Me këtë Vendim njoftohen:**, Anëtarët e deleguar të KK, Asociacioni i Komunave të Kosovës, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK

| Data 17.01.22 | Vendi KAÇANIK | |
|---|---|---|
| Nj. org. | Numri | Shtojcë |
| 01 | 104/02-1700 /1. | |

Asociacioni i Komunave të Kosovës
Asocijacija Kosovskih Opština
Association of Kosovo Municipalities

**ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS**

| | |
|---|---|
| Për: | **Kryetar i Komunës dhe**<br>**Kryesues/e i/e Kuvendit të Komunës** |
| Nga: | **Sazan Ibrahimi – Drejtor Ekzekutiv, Asociacioni I Komunave të Kosovës** |
| Data : | **14 Janar 2022** |
| Subjekti : | **Formula për zgjedhjen e delegatit të AKK-së** |

**I nderuar Kryetar,**

**I/E nderuar Kryesues/e i/e Kuvendit të Komunës,**

Numri I delegateve per Kuvend te AKK-se eshte caktuar ne baze te kritereve te shenuarane vijim:

Perveç Kryetarit te Komunes, komunat i delegojnë për çdo 10 anetar te KK-se, 1 (një) përfaqësues

në Kuvendin e AKK-se. Kërkohet edhe përfaqësimi i partive politike. Në Kuvend marrin pjesë edhe përfaqësuesit e minoriteteve në pajtim të një marrëveshjeje të kryetarëve të komunave (numri dhe përkatësia ne baze te perfaqesimit te tyre ne KK). Komunat do t'i zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e asociacionit, në proporcion me numrin e votave që partia i ka fituar në kuvendin komunal. Kjo formule e perfaqesimit eshte aplikuar qe nga fillimi.

**Me respekt,**

**Sazan Ibrahimi**

**Drejtor Ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës**